VENDIM
Nr. 627 , datë 27.10.2021

PËR KALIMIN TE BASHKITË KURBIN E LEZHË, TË OBJEKTEVE ARSIMORE, SHKOLLA 9-VJEÇARE DHE KOPSHTI "DAN BAJRAMI", BASHKIA KURBIN, SHKOLLA E MESME DHE PARASHKOLLORI "LLESH NIK DAKA", BASHKIA LEZHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Kurbin e Lezhë, përkatësisht, të objekteve arsimore, shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Dan Bajrami", Bashkia Kurbin, shkolla e mesme dhe parashkollori "Llesh Nik Daka", Bashkia Lezhë, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Kurbin e Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama